




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dop.	Nr. Prot.
Dop. <u>2-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-1948/20</u>
Nr. i tat.	Data
Broj. stranica <u>02</u>	Datum <u>24-05-2012</u>
Nr. pages	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK– 03-5102/11, për Zyrtarin z.Banush Pacolli, Zëvendës Ministër i Ministrisë se Infrastrukturës, në Qeverinë e Republikës e Kosovës, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-5102/11,që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Banush Pacolli,Zëvendës Ministër i Ministrisë se Infrastrukturës, në Qeverinë e Republikës e Kosovës

Pas zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si Zëvendës Ministër i Ministrisë se Infrastrukturës, ka qenë duke punuar si këshilltar i Drejtorit ne Kompaninë "Esarom-Kosova" ne Hajvali , që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 7.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z.Banush Pacolli, Zëvendës Ministër i Ministrisë se Infrastrukturës, në Qeverinë e Republikës e Kosovës, ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë si dhe ka kërkuar te ballafaqohet me faktet qe posedon Agjencia.

Me datën 19.03.2012, jemi takuar z.Banush Pacolli, ne zyrtar e ministrisë se Infrastrukturës, gjat takimit është biseduar për gjendjen dhe faktet qe disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit.

Zyrtari i Lartë, z.Banush Pacolli, Zëvendës Ministër i Ministrisë se Infrastrukturës, në Qeverinë e Republikë se Kosovës ,gjatë takimit është pajtuar për situatën mir po është arsytuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi qe nuk e ka informuar as kush qe nga momenti i zgjedhjes si Zëvendës Ministër i Ministrisë se Infrastrukturës, dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë qe mundë te shkaktoj Konflikt te mundshme të Interesit dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, pasi qe ka punuar vetëm pas orarit te punës.

z.Banush Pacolli, Zëvendës Ministër i Ministrisë se Infrastrukturës, në Qeverinë e Republikës e Kosovës, është zotuar se ne afatin ligjor do të ndërpres punën si këshilltar i drejtorit ne biznesin "Esarom-Kosova" ku është edhe biznes familjare, dhe do ta bej shmangien e Konfliktit te mundshëm të Interesit duke mos zhvilluar tjetër aktivitetet private, gjatë kohës sa ushtron funksionin Publik.

Me datën 17.04.2012, Zyrtari i Lartë, z.Banush Pacolli, Zëvendës Ministër i Ministrisë se Infrastrukturës, në Qeverinë e Republikës e Kosovës, ka sjellë dëshminë se ka pezulluar te gjitha aktivitetet dhe veprimtarin ne biznesin "Esarom-Kosova". Më ane te dokumentit te nënshkruar nga drejtori i kompanisë "Esarom-Kosova" dëshmohet se z.Banush Pacolli ka ndërprerë veprimtarin si këshilltari Drejtorit ne Kompaninë "Esarom-Kosova" andaj kundrojmë se ka shmangur gjendjen e Konfliktit te Interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

